**Republika e Kosovës/**

**Republika Kosova-RepublicofKosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-MinistarstvoTrgovine i Industrije/MinistryofTradeandIndustry*

**Departamenti i Industrisë**
**DepartmentIndustrije/DepartmentofIndustry**

# RAPORTI VJETOR I ZHVILLIMIT INDUSTRIAL NË KOSOVË PËR VITIN 2013

**dhjetor, 2014**

# PËRMBAJTJA


1. Lista e shkurtesave te përdorura ........................................................................2
2. Hyrje.........................................................................................................3
3. Metodologjia..............................................................................................4
4. Analiza makro-ekonomike për vitin....................................................................5
    a. BPV ...................................................................................................5
    b. Llogaritë qeveritare...................................................................................6
    c. Norma e punësimit....................................................................................7
    d. Pjesëmarrja në fuqinëpunëtore.....................................................................8
    e. Fuqia punëtore e përgjithshme.....................................................................9
    f. Të punësuar..........................................................................................10
    g. Tregtia e jashtme.....................................................................................11
    h. Investimet e huaja...................................................................................12
5. Analiza sektoriale........................................................................................14
    a. Prodhimi vendor......................................................................................14
        i. Nr. i bizneseve të angazhuara sipas sektorëve industrialë....................14
        ii. Qarkullimi vjetor sipas rajoneve...........................................................15
    b. Fuqia punëtore.......................................................................................17
        i. Nr. i të punësuarve, sipas sektorëve industrialë.....................................17
        ii. Paga mesatare, sipas aktiviteteve ekonomike.......................................18
        iii. Numri i bizneseve sipas rajoneve..........................................................21
        iv. Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Prishtinës..................22
        v. Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Mitrovicës................23
        vi. Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Pejës.........................24
        vii. Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Gjilanit.....................26
        viii. Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Prizrenit....................27
    c. Tregtia e jashtme.....................................................................................29
        i. Eksport-Importi sipas viteve............................................................29
        ii. Eksporti me vendet e CEFTA-s, BE-ë dhe vendet tjera....................30
        iii. Eksporti me vendet e CEFTA-s........................................................31
        iv. Eksporti me vendet e BE-së................................................ ..........32
        v. Importi me vendet e CEFTA-s, BE-së dhe vendet tjera.....................33
        vi. Importi nga vendet e CEFTA-s.........................................................34
        vii. Importet nga vendet e BE-së.............................................................35
        viii. Eksport-Importi, bilanci tregtar dhe mbulimi i importit me eksport mevendet e CEFTA-s......................................................36
        ix. Eksport-Importi, bilanci tregtar dhe mbulimi i importit me eksport mevendet e BE-së...........................................................37
    d. Tregu financiar.......................................................................................38
        i. Norma mesatare vjetore e interesit në depozita dhe kredi......................38
    e. Indeksi içmimeve të konsumatorit, sipas aktiviteteve ekonomike.......................40
    f. Struktura e prodhimit industrial sipas nomenklaturës NACE REV 1-së………..42

## Lista e shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

BKK  - Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

BPV – BrutoProdhimi Vendor

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DI – Departamenti i Industrisë

DK - Dogana e Kosovës

DPI - Divizioni për zhvillimin e Politikave Industriale

IHD - Investimet e Huaja Direkte

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTLEQ – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore

NMVID - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita

NMVIK - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Kredi

SWOT – Strength (Përparësitë), Weakneses (Mangësitë), Opportunities (Mundësitë), Threats (Rreziqet)

# Hyrje

Në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), funksionon edhe Departamenti i Industrisë (DI), nën mandatin e të cilit bie, në mes tjerash edhe roli i monitorimit dhe analizimit të trendëve të zhvillimit të industrisë në Kosovë. Në këtë drejtim, DI tanimë ka ndërtuar një traditë në përgatitjen e raporteve vjetore statistikore dhe analitike mbi zhvillimin e aktiviteteve industriale.

Qëllimi i këtij raporti vjetor është paraqitja e trendëve kryesorë zhvillimorë të ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë në degët kryesore industriale gjatë vitit 2013. Si i tillë Raporti do të shërbejë në procesin e zhvillimit ekonomik në Kosovë,në përgjithësi dhe në veçanti do t'iu shërbejëpolitikbërsve, bizneseve operuese të tanishme dhe potenciale nga sektori privat, investitorëve të huaj, donatorëve, hulumtuesve akademikë etj. Paraqitja e statitistikave dhe analizat e pëfshira në këtë raport ofrojnë një pasqyrë më të qartë rreth trendëve kryesorë me ndikim në industrinë e vendit. Më konkretisht, përmes këtij raporti mendohet që të lehtësohet puna e hisedarëve në zhvillimin e politikave të bazuara nëindikatorë të matshëm, përveç tjerash.

Për dallim nga raporti i kaluar kësaj radhe përveç indikatorëve kryesorë të nivelit sektorial/industrial, janë përfshirë edhe indikatorët e nivelit makro-ekonomik, ata tëtregut financiar, tregut të punës, investimeve të huaja direkte dhe tregtia e jashtme, të cilët ndikojnë në zhvillimin industrial në një mënyrë apo tjetër.

# Metodologjia

Qasja e përpilimit të këtij raporti, i takon asaj përshkruese dhe pozitive, pasi që analistët e DPI-së kanë tentuar që të vënë në pah trendët kryesorë në fushën e zhvillimit industrial në Kosovë.

Ky raport realizohet për aktivitetet ekonomike të zhvilluara në vitin 2013, që do të thotë se fokusi i analizavebie mbi këtë kohë, por trendët e indikatorëve të paraqitur datojnë nga viti 2009.

Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga institucionet përgjegjësesi: ASK, ARBK, ATK, BQK dhe Doganat e Kosovës, kurse përpunimi, paraqitja grafike dhe analizimi i tyre është bërë nga Departamenti i Industrisë, përkatësisht, Divizioni për zhvillimin e Politikave Industriale (DPI).

# Analiza makro-ekonomike

## Bruto Prodhimi Vendor

Siç mund të shihet në Figurë 1, edhe gjatë vitit 2013, Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të rritet; mirëpointensiteti i asaj rritjeje ishte relativisht më i madh sesa ai i vitit paraprak.

**Figura 1: Norma aktuale e rritjes së BPV-së**




Për më shumë, vlera nominale e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) gjatë vitit 2013, është rritur për 5.3% (268 € milion) apo 5,059 € milion sa ishte në vitin 2012 në5,327€ milion në vitin 2013. Trendi pozitiv u realizua edhe sa i përket normës reale të rritjes (3%) së BPV-sëdhe BPV-se (4.8%) për kokë banori gjatë vitit 2013, krahasuar me vitin 2012.

**Tabela 1: Indikatorët kryesorë makro-ekonomik, 2008-2013**

| Viti | BPV (çmime aktuale, në milion €) | Norma e rritjes së BPV-së (aktuale) | Norma e rritjes së BPV-së (reale) | BPV për kokë banori (në €) |
|---|---|---|---|---|
| 2009 | 4,070 | 4.8% | 4% | 2,329 |
| 2010 | 4,402 | 8.2% | 3% | 2,480 |
| 2011 | 4,815 | 9.4% | 4% | 2,672 |
| 2012 | 5,059 | 5.1% | 3% | 2,799 |
| 2013 | 5,327 | 5.3% | 3% | 2,935 |

## Llogaritë qeveritare

Siç shihet në Figurën 2, edhe në vitin 2013 pjesëmarrja e përbërësve të BPV-së shikuar nga qasja e shpenzimeve, ka qëndruar relativisht e njëjtë, ku shpenzimet e konsumit final ishin komponentë kryesore, ndjekur nga formimi i kapitalit bruto, eksporti i shërbimeve dhe mallrave.

**Figura 2: Disa nga Llogaritë Kombëtare, 2009-2013 (në milion €)**




Siç shihet edhe në  Tabelën nr. 2,  që brenda për brenda komponentëssëshpenzimeve të konsumit final, shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake edhe gjatë vitit 2013,vazhduan të mbesin elementet kryesore, të cilat krahasuar nga viti paraprak,u rritën për 4.1%, apo nga  5,320.4€milion në 5.539.3 € milion, respektivisht.

Më pastaj, ishin shpenzimet e konsumit final të Qeverisë, ato që u renditën si komponenti i dytë kryesor,i cilishënoi një rritje prej 2.6%. Gjatë vitit 2013, ato arritënvlerën prej  863.9 € milionë, apo 21.8€milionë më shumë sesa që ishin në vitin paraprak. Nga shuma e përgjithshme e këtyre shpenzimevenë vitin 2013, 23.7% ishin të financuara nga donatorët, kurse pjesa tjetër nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).

Ndërkaq, sa upërkettrendëve të nën-komponentëve (Formimi i bruto-kapitalit fiks dhe ndryshimet në inventar) të komponentëssë dytë kryesore të BPV-së (Formimi i bruto-kapitalit), ato mbetën të njëjta edhe gjatë vitit 2013. Përmë shumë, vlera e përgjithshme e tyre pati një rritje prej 0.4% në vitin 2013 (€1,470.9 milion) krahasuar me vitin paraprak (1,465.1€).

Gjithashtu, Eksporti Neto përbëntenjë ndër komponentët kryesorë të BPV-së, i cili ashtu sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe në vitin 2013, ndikoi relativisht dukshëm në mënyrë negative. Sidoqoftë, vlera e tij realegjatë vitit 2013, krahasuar me vitin paraprak u rrit (vlera nominale u zvogëlua)për 2.5%, falëreniessëvlerës së importit të mallrave dhe shërbimeve (1.4%) dhe ngritjes sëasajtë eksportit të mallrave dhe shërbimeve (0.5%).

Në kontekstin e njëjtë kohor, brenda këtijkomponenti të BPV-së, eksporti i mallrave dhe importi i shërbimeve patënshkallën relativisht më të lartëtë rritjes, 6.3% respektivisht 8.6%, Po ashtuishte importi i mallrave dhe ai i shërbimeve që përjetuan ndryshimet më të mëdha në vlerë nominale, ku krahasuar me vitin paraprak, eksporti i mallravepësoinjërënie prej €63 milionë, kurse i dyti një ngritje prej €25 milionë.

**Tabela 2: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale sipas qasjes së shpenzimeve 2008-2013**

| Viti | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e konsumit final** | 4,172.20 | 4,221.60 | 4,516.50 | 4,975.50 | 5,320.40 | 5,539.30 |
| **Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake** | 3,488.90 | 3,528.50 | 3,768.20 | 4,142.30 | 4,458.10 | 4,652.40 |
| **Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë** | 659.8 | 668.1 | 722.3 | 802.1 | 842.1 | 863.9 |
| **Qeveria e Kosovës** | 358 | 407.2 | 495.7 | 578.4 | 625 | 658.8 |
| **Donatorët (pagat)** | 301.8 | 260.8 | 226.6 | 223.7 | 217.1 | 205.2 |
| **Të punësuar të huaj** | 196.9 | 178.7 | 157.4 | 155.5 | 150.9 | 142.6 |
| **Të punësuar vendorë** | 104.9 | 82.1 | 69.2 | 68.2 | 66.2 | 62.6 |
| **Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH** | 23.6 | 25 | 26 | 31.1 | 20.2 | 23 |
| **Formimi i bruto kapitalit** | 1,208.70 | 1,267.40 | 1,450.60 | 1,632.40 | 1,465.10 | 1,470.90 |
| **Formimi i bruto kapitalit fiks** | 1,052.70 | 1,129.80 | 1,301.20 | 1,475.90 | 1,316.80 | 1,322.60 |
| **Ndryshimet në inventar** | 156 | 137.6 | 149.4 | 156.5 | 148.3 | 148.3 |
| **Eksporti neto** | 1,498.20 | 1,419.40 | 1,565.2 - | 1,793.30 | 1,726.80 | 1,683.60 |
| **Eksporti i mallrave dhe shërbimeve** | 608.9 | 694.9 | 878 | 943.4 | 922.1 | 927.1 |
| **Eksporti i mallrave** | 216.6 | 177.2 | 305 | 324.9 | 287 | 305.1 |
| **Eksporti i shërbimeve** | 392.4 | 517.6 | 573 | 618.5 | 635.1 | 622 |
| **Importi i mallrave dhe shërbimeve** | 2,107.10 | 2,114.20 | 2,443.10 | 2,736.70 | 2,648.80 | 2,610.70 |
| **Importi i mallrave (FOB)** | 1,866.30 | 1,828.90 | 2,057.10 | 2,383.90 | 2,360.00 | 2,297.10 |
| **Importi i shërbimeve** | 240.8 | 285.3 | 386.1 | 352.8 | 288.8 | 313.7 |

## Norma e punësimit

Sipas të dhënave të AnketëssëFuqisëPunëtore të realizuar nga ASK, shkalla e papunësisësë përgjithshme në Kosovë, gjatë vitit 2013, krahasuar me vitin paraprak,pësoinjërënie relativisht tëvogël nga 30.9% të 30%, respektivisht.

**Tabela 3: Shkallet e papunësisë**

| Shkalla e papunësisë | 2012 | 2013 |
|---|---|---|
| Shkalla e papunësisësëpërgjithshme (ne %) | 30.9% | 30.0% |
| Shkalla e papunësisë te femrat (ne %) | 40.0% | 38.8% |
| Shkalla e papunësisë te meshkujt (in %) | 28.1% | 26.9% |

Siç mund të shihet në Figurën 3, shkalla e papunësisëte femrat ishte relativisht më e lartë sesa te meshkujt. Përmë tepër, ndryshimimesshkallës sëpapunësisëmesmeshkujve dhe femrave vazhdoi të mbetet injëjtë (1.2% ishte shkalla e rënies për të dytë kategoritë).

**Figura 3: Shkallet e papunësisë**




## Pjesëmarrja në fuqinëpunëtore

Pjesëmarrja e përgjithshme në fuqinëpunëtoreshënoi ngritje gjatë vitit 2013, krahasuar me vitin paraprak, meqë rast relativisht mëi theksuar ishte ngritja e pjesëmarrjes së meshkujve. Siç mund të shihet në Figurën 4, Kosova ende kanjë hendek relativisht të dukshëmmespjesëmarrësve femra dhe meshkuj në fuqinë punëtore.

**Figura 4: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore**




Nga Tabela 4, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore gjatë vitit 2013, krahasuar mevitin paraprak, kishte një ngritje prej 3.6%. Në vitin 2013, pjesëmarrja e femrave në fuqinëpunëtore ishte21.1%, që përfaqëson një ngritje prej 3.3%, krahasuar mevitin paraprak, kurse te meshkujt ishte 60.2% dhe 4.8%, respektivisht.

Hendekumespjesëmarrjes në fuqinëpunëtoremesfemrave dhe meshkujve është zgjeruar edhe më shumë gjatë vitit 2013, krahasuar mevitin paraprak.

**Tabela 4: Pjesëmarrja të fuqinë punëtore**

| Viti | 2012 | 2013 |
|---|---|---|
| Pjesëmarrja të fuqinë punëtore (ne %) | 36.9% | 40.5% |
| Pjesëmarrja e femrave të fuqinë punëtore (ne %) | 17.8% | 21.1% |
| Pjesëmarrja e meshkujve të fuqinë punëtore (ne %) | 55.4% | 60.2% |

## Fuqia punëtore e përgjithshme

Fuqia punëtore e përgjithshme gjatë vitit 2013,patinjë rritje relativishttë dukshme(10.18%),krahasuar më vitin paraprak, sidomos ajoe gjinisë femërore (20.29%).

**Figura 5: Fuqia punëtore (në njerëz)**




Sipas të dhënave të paraqitura nëTabelënnr. 5, mund të shihet qëgjatë vitit 2013, fuqia punëtore e meshkujve u rrit relativisht më ngadalë sesa ajo e femrave.

Përkundër kësaj, femrat gjatë atij vitipërfaqësuan vetëmafërsisht 26% të fuqisëpunëtore të përgjithshme.

**Tabela 5: Fuqia punëtore (në njerëz)**

| Fuqia punëtore | 2012 | 2013 | Ndryshimi vjetor (në %) |
|---|---|---|---|
| Fuqia punëtore, femra | 333,789 | 126,007 | 20.29% |
| Fuqia punëtore, meshkuj | 104,755 | 357,186 | 7.01% |

## Të punësuar

Numri i femrave të punësuara gjatë vitit 2013, krahasuar me vitin paraprak, u ngrit  mirëpo ato përfaqësuan vetëm një nga pesë personat në marrëdhënie pune, siç edhe shihet në Figurën 6.

**Figura 6: Të punësuar, sipas gjinisë (në njerëz)**



Ndërkohë, në Tabelën nr. 6, mund të vërehet që numri i femrave dhe meshkujvetë punësuar gjatë vitit 2013, që nëse e krahasojmë me vitin paraprak, rezulton me një ngritje prej 18.5% dhe 8.1%, respektivisht.

**Tabela 6: Të punësuar, sipas gjinisë (në njerëz)**

| **Viti** | **2012** | **2013** | **Ndryshimi vjetor (nëpersona)** |
|---|---|---|---|
| **Të punësuar, femra** | 62,853 | 77,120 | 14,267 |
| **Të punësuar, meshkuj** | 239,994 | 261,244 | 21,250 |
| **Të punësuar, në përgjithësi** | 302,847 | 338,364 | 35,517 |

## Tregtia e jashtme

Qysh nga paslufta, Kosova ende ka vazhduar të ketënjëbilanc tregtar negativ, por gjatë vitit 2013, vlera e tij ai pësoinjërënieprej2.47%, kryesisht falërënies së importit prej 1.43%, dhe pjesërisht për shkak të ngritjes sëeksportit prej 0.53%.

**Figura 7: Eksporti, importi dhe bilanci tregtar i përgjithshëm, 2009-2013 (çmime aktuale milion €)**




Për më shumë, në Tabelën 7, mund të shihet qëkrahasuar më vitin paraprak, gjatë vitit 2013,importi i përgjithshëmpësoinjërënie prej €48 milionë, përshkak tërënies sëvlerës së importit të mallrave (€63 milionë) më shumë sesa ngritjes së vlerës së importit të shërbimeve (€25 milion).

**Tabela 7: Eksporti, importi dhe bilanci tregtar i përgjithshëm, 2009-2013**

| Viti | Eksporti i përgjithshëm (në çmime aktuale € milion) | Eksporti i shërbimeve (në çmime aktuale € milion) | Eksporti i mallrave (në çmime aktuale € milion) | Importi i përgjithshëm (në çmime aktuale € milion) | Importi i shërbimeve (në çmime aktuale € milion) | Importi i mallrave (në çmime aktuale € milion) | Bilanci tregtar (në çmime aktuale € milion) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2009 | 695 | 518 | 177 | 2,114 | 285 | 1,829 | (1,419) |
| 2010 | 878 | 573 | 305 | 2,443 | 386 | 2,057 | (1,565) |
| 2011 | 943 | 619 | 325 | 2,737 | 353 | 2,384 | (1,793) |
| 2012 | 922 | 635 | 287 | 2,649 | 289 | 2,360 | (1,727) |
| 2013 | 927 | 622 | 305 | 2,611 | 314 | 2,297 | (1,684) |

## Investimet e huaja

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, gjatë vitit 2013,patë një ngritje, pas njërënieje relativisht të dukshme gjatë vitit paraprak, siç mund të shihet të Figurën 8.

**Figura 8: Investimet e Huaja Direktenë Kosovë**




Më konkretisht, viti 2013, ishte periudha kur IHD-tëarritënvlerën prej €280.2 milionë, që krahasuar më vitin paraprak paraqet një ngritje prej 22.3%.

**Tabela 8: Investimet e Huaja Direktenë Kosovë**

| Viti | Investimet e Huaja Direkte |
|---|---|
| **2007** | 440.7 |
| **2008** | 369.9 |
| **2009** | 295.5 |
| **2010** | 368.5 |
| **2011** | 384.4 |
| **2012** | 229.1 |
| **2013** | 280.2 |

Gjatë vitit 2013, siç është paraqitur në fig. 9., Patundshmëria ishte aktiviteti ekonomik më tërheqës për investitorët e huaj, ndjekur nga ai i Transportit dhe Telekomunikacionit,Shërbimeve Financiare dhe Ndërtimit. Vlen të ceket që aktivitetet ekonomik mengritjen më të lartë në aspektin e thithjes së investimeve të huaja gjatë vitit 2013, krahasuar më vitin paraprak janë: Energjetika, Transporti, Telekomunikacioni dhe Patundshmëria.

**Figura 9: Investimet e Huaja Direkte, sipas aktivitetit ekonomik (pranime), (në %)**




Ashtu siç mund të shihetnë Tabelën 9, gjatë vitit 2013, sektori i patundshmërisë pranoi rreth 35.4% të vlerës së përgjithshme të IHD-ve. Një e treta tjetër e vlerës së përgjithshme të IHD-ve u nda përafërsisht barabartmes aktiviteteve ekonomike të lidhura me aktivitetin ekonomik të Ndërtimtarisë (15.1%) dhe Transportit dhe Telekomunikacionit (14.2%). Përmë shumë, një e tretae vlerëssë përgjithshme të IHD-ve ishte orientuar kryesisht në këto aktivitete ekonomike: Shërbime Financiare (11%), Energjetika (7.6%), Prodhimi (6.9%) dhe Shërbime Tregtare, pastrimi, etj. (6.2%).

Ndërkaq, sa u përket aktiviteteve ekonomike si Industria Përpunuese, Bujqësia, Minierat, së bashku tërhoqënvetëm 1% të vlerëssë përgjithshme të IHD-ve gjatë vitit 2013, për dallim nga viti paraprak, meqë me këtë rast kishin pranuar rreth 5%. Ky ndryshim erdhi kryesisht si pasojë e rëniessëIHD-venë aktivitetin ekonomik tëMinierave.

**Tabela 9: Investimet e Huaja Direkte, sipas aktivitetit ekonomik (në %)**

| **Përshkrimi** | **Gjithsej** | Shërbime Financiare | Prodhimi | Patundshmëria | Transporti dhe Telekomunikacioni | Energjetika | Minierat | Ndërtimi | Industria Përpunuese | Bujqësia | Shërbime tregtare, pastrimi, Mbledhja | Këshillimi Operimi, Hulumtimi | Shërbimet sanitare | Tjera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2007 | 100% | 23.1% | 9.0% | 7.0% | 29.3% | 0.6% | 9.4% | 1.2% | 8.0% | 1.8% | 2.9% | 1.0% | 2.9% | 3.8% |
| 2008 | 100% | 34.9% | 6.0% | 16.8% | 13.8% | 4.5% | 4.7% | 3.7% | 8.5% | 2.3% | 2.7% | 0.6% | 0.6% | 0.9% |
| 2009 | 100% | 25.5% | 17.1% | 14.9% | 7.4% | 2.9% | 2.4% | 12.0% | 2.4% | 4.4% | 5.5% | 0.9% | 0.8% | 3.8% |
| 2010 | 100% | 19.5% | 19.8% | 13.4% | 4.0% | 0.1% | 2.7% | 24.9% | 6.9% | 0.6% | 3.3% | 2.3% | 0.7% | 1.9% |
| 2011 | 100% | 8.9% | 12.8% | 16.3% | 6.2% | 0.0% | 0.8% | 34.3% | 0.5% | 0.1% | 2.1% | 2.0% | 0.0% | 16.0% |
| 2012 | 100% | 10.4% | 12.1% | 31.7% | 7.9% | 1.3% | 4.6% | 20.8% | 0.4% | 0.1% | 3.6% | 1.6% | 0.3% | 5.1% |
| 2013 | 100% | 11.0% | 6.9% | 35.4% | 14.2% | 7.6% | 0.9% | 15.1% | 0.0% | 0.1% | 6.2% | 0.7% | 0.1% | 1.6% |
| | | 133.3% | 83.7% | 135.5% | 82.9% | 17.1% | 25.4% | 111.9% | 26.7% | 9.5% | 26.2% | 9.1% | 5.4% | 33.3% |

# Analiza sektoriale

# Prodhimi vendor

## Numri i bizneseve të regjistruara nëpër nënsektorët e prodhimit industrial

Të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 10, tregojnë për numrin e regjistrimit të bizneseve nëpër vite, 2009 deri 2013, sipas nënsektorëve. Përderisa në tre vjetët e para shohim se kemi pasur një trend të njëjtë, sa i përket numrit të bizneseve, në vitin 2012, është shënuar një rritje prej 3% që të bizneseve të regjistruara. Të dhënat për vitin 2013, tregojnë se përsëri është shënuar një ulje e regjistrimit të bizneseve për 2.2 % apo nga 7.1% në 5.3%.

Një rënie më e madhe është regjistruar te nënsektoriDN-34 që ka të bëjë me mjetet e transportit, ku vërehet se në numrin e gjithmbarshëm të bizneseve  në vitin 2012, kishte një pjesëmarrje prej 20 %,ndërsa në vitin 2013, kjo përqindje e pjesëmarrjes është zvogëluar në -16.7%. Po ashtu ulje është shënuar edhe te nënsektori DF – 23 apo te Rafinimi i naftës dhe koksifikimi, i cili nënsektor, në vitin 2012, merrte pjesë me 33.3% në numrin e përgjithshëm të regjistrimit të biznesit kurse në vitin paraprak kjo përqindje ra në zero.Poashtu  rënie është shënuar edhe te nënsektori DL-31 apo maikinat dhe aparatet elektrike nga 25%, në vitin 2012,  në 0.7%, në vitin 2013.

**Tabela 10; Numri i bizneseve të angazhuara nëpër nënsektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës, sipas viteve**

| Nën sektorët | 2009 Bizneset | 2009 % | 2010 Bizneset | 2010 Rritja në % | 2011 Bizneset | 2011 Rritja në % | 2012 Bizneset | 2012 Rritja në % | 2013 Bizneset | 2013 Rritja në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DA-15 | 1094 | 0 | 1061 | -3.0 | 1114 | 5.0 | 1193 | 7.1 | 1288 | 8.0 |
| DA-16 | 5 | 0 | 6 | 20.0 | 6 | 0.0 | 5 | -16.7 | 7 | 40.0 |
| DB-17 | 123 | 0 | 122 | -0.8 | 112 | -8.2 | 141 | 25.9 | 152 | 7.8 |
| DB-18 | 184 | 0 | 180 | -2.2 | 199 | 10.6 | 220 | 10.6 | 239 | 8.6 |
| DC-19 | 34 | 0 | 28 | -17.6 | 29 | 3.6 | 36 | 24.1 | 38 | 5.6 |
| DD-20 | 606 | 0 | 593 | -2.1 | 581 | -2.0 | 586 | 0.9 | 596 | 1.7 |
| DE-21 | 53 | 0 | 52 | -1.9 | 60 | 15.4 | 77 | 28.3 | 93 | 20.8 |
| DE-22 | 276 | 0 | 300 | 8.7 | 299 | -0.3 | 303 | 1.3 | 323 | 6.6 |
| DF-23 | 8 | 0 | 7 | -12.5 | 6 | -14.3 | 8 | 33.3 | 8 | 0.0 |
| DG-24 | 113 | 0 | 115 | 1.8 | 116 | 0.9 | 125 | 7.8 | 135 | 8.0 |
| DH-25 | 294 | 0 | 306 | 4.1 | 334 | 9.2 | 371 | 11.1 | 384 | 3.5 |
| DI-26 | 387 | 0 | 413 | 6.7 | 421 | 1.9 | 441 | 4.8 | 473 | 7.3 |
| DJ-27 | 134 | 0 | 123 | -8.2 | 120 | -2.4 | 123 | 2.5 | 133 | 8.1 |
| DJ-28 | 539 | 0 | 535 | -0.7 | 579 | 8.2 | 607 | 4.8 | 623 | 2.6 |
| DK-29 | 30 | 0 | 30 | 0.0 | 31 | 3.3 | 34 | 9.7 | 34 | 0.0 |
| DL-30 | 4 | 0 | 4 | 0.0 | 7 | 75.0 | 6 | -14.3 | 7 | 16.7 |
| DL-31 | 36 | 0 | 35 | -2.8 | 32 | -8.6 | 40 | 25.0 | 37 | -7.5 |
| DL-32 | 9 | 0 | 7 | -22.2 | 6 | -14.3 | 6 | 0.0 | 6 | 0.0 |
| DL-33 | 15 | 0 | 19 | 26.7 | 16 | -15.8 | 19 | 18.8 | 20 | 5.3 |
| DM-34 | 3 | 0 | 4 | 33.3 | 5 | 25.0 | 6 | 20.0 | 5 | -16.7 |
| DM-35 | 3 | 0 | 5 | 66.7 | 5 | 0.0 | 7 | 40.0 | 8 | 14.3 |
| DN-36 | 302 | 0 | 313 | 3.6 | 352 | 12.5 | 366 | 4.0 | 374 | 2.2 |
| DN-37 | 101 | 0 | 99 | -2.0 | 104 | 5.1 | 134 | 28.8 | 130 | -3.0 |
| **Gjithsej** | **4353** | **0** | **4357** | **0.1** | **4534** | **4.1** | **4854** | **7.1** | **5113** | **5.3** |

**Figura 10: paraqitja grafike e numrit të bizneseve të angazhuara nëpër nësektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës e sipas viteve, 2009-2013**



Përderisa numri më i madh i nënsektorëve ka shënuar rënie, për këtë periudhë kohore, sipas regjistrimit të biznesit, në një numër të vogël të sektorëve është shënuar rritje. Sipas numrit të bizneseve, në vitin 2013, rritja më e madhe është shënuar në nënsektorin e duhanit, ku nga një pjesëmarrje me -16.7 % që merrte pjesë në numrin e përgjithshëm të bizneseve (nga krahasimet e viteve të mëparshme) është shënuar një rritje prej 40 % në numrin e përgjithshëm të bizneseve.

**<u>Qarkullimi vjetor i realizuar sipas rajoneve dhe nënsektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës për vitet2012/2013</u>**

Të dhënat e qarkullimit vjetor sipas rajoneve tregojnë se në vitin 2013, prin rajoni i Prizrenit, me një shumë totale prej € 272.473.247, nga vlera e të hyrave të përgjithshme vjetore. Ndërsa në këtë rajon ështëIndustria ushqimore, e cila kishte një vlerë qarkulluese me një shumë prej € 105.351.552,apo afërsisht rreth 40% të shumës totale. Sektorët tjerë të cilët gjithashtu shënuan qarkullim të vlerësuar janë: produktet tjera minerale jo-metalike dhe ato metalike-përveç makinave dhe pajisjeve me € 76.645.044, respektivisht € 10.905.817, produktet e tekstilit me € 10.319.020 dhe produktet nga goma dhe plastika në vlerë prej € 37.931.790).

Me një shumë apo trend të përafërt prej € 258,377.621 është rajoni i Prishtinës. Përderisa shuma totale e produkteve ushqimore është e përafërt me atë te rajonit të Prizrenit, qarkullimi në vlerë prej € 103. 934.189), përqendrimi i prodhimit të nën-sektorëve tjerë ka shpërndarje më të balancuar apo qarkullim më të qëndrueshëm. Nga sektorët tjerë, është ai i veprimtarisë botuese me €25,361.659 qëdel më dominuesi krahasuar me rajonet.

Rajoni i Mitrovicës, i njohur si rajoni më i integruar industrial përgjatë ish-sistemit centralist, sot na paraqitet si rajon që përballet me vështërsitëmë të mëdha në adaptimin e tregut të lirë. Me një qarkullim të përgjithshëm prej vetëm € 36, 618.930 të ndërmarrjeve, ky rajon aktualisht akumulon vetëm 1/8 nga shuma e përgjithshme. Qarkullimi i përgjithshëm, për vitin 2013, në rajonin e Gjilanit është në vlerë prej € 173.278.244, ndërsa ai në rajonin e Pejës,në vlerë prej € 160, 848.086. Këto të dhëna tregojnë se kemi të bëjmëme një ngritje apo trend pozitiv tëqarkullimit industrial karshi periudhave të mëparshme.Në rajonin e Gjilanit, janë nën-sektorët industrialë në formë tëprodukteve minerale jo-metalike, € 36.470.645, të metalit € 11.656.232 dhe ato nga goma/plastika në vlerë prej €24.673.894, të cilat ofrojnë kontributin kryesor në qarkullimin e përgjithshëm tëpërcjellë edhe nga nën-sektori i produkteve ushqimore, € 65.832,758), ai i përpunimit të duhanit me vlerë€ 18.672.229 dhe nga Industria e Drurit, siç ështëprodhimi i mobileve.

**Tabela 11: Qarkullimi vjetor i realizuar sipas rajoneve në nivel të Kosovës për vitin 2012, 2013**

| Komuna | 2012 Qarkullimi | % | 2013 Qarkullimi | % | 2013/2012 në % |
|---|---|---|---|---|---|
| Mitrovicë | 26,042,524 | 3.2 | 36,618,930 | 4.1 | 40.6 |
| Pejë | 137,784,980 | 16.8 | 160,848,086 | 17.8 | 16.7 |
| Prizren | 190,244,295 | 23.2 | 272,473,247 | 30.2 | 43.2 |
| Gjilan | 219,229,152 | 26.7 | 173,278,944 | 19.2 | -21.0 |
| Prishitnë | 246,604,814 | 30.1 | 258,377,621 | 28.7 | 4.8 |
| **Gjithsej** | **819.905.765** | **100.0** | **901.596.828** | **100.0** | **10.0** |

**Figura 11: Paraqitja grafike e qarkullimit vjetor të realizuar sipas rajoneve në nivel të Kosovës për vitin 2012, 2013**




## Fuqia punëtore

### <u>Numri itë punësuarve karshi bizneseve dhe qarkullimit vjetor sipas sektorëve në vlerë dhe përqindje, 2013</u>

Në relacion me numrin e të punësuarve sipas sektorëve industrialë, në nivel të Kosovës, numri i të punësuarve, jopërherë, gjen një përputhshmëri paralele karshi të hyrave të përgjithshme nga qarkullimi vjetor dhe numri i ndërmarrjeve, relativisht tësektorëve industrialë. Referuar tëdhënave të përpunuara, siç shihet nëTabelën nr. 12, është sektori i prodhimit të ushqimit dhe pijeve, ai i cili paraprin në relacion me shifrat e punësimit përgjatë vitit 2013, konkretisht numrit të të punësuarve me rreth 6261 apo 29% e numrit të përgjithshëm tëtë punësuarve.

Ky sektor është i pasuar nga ai i prodhimeve të mineraleve jo-metalike me një numër prej 3776 apo 17.5% nga totali i përgjithshëm. Me një avantazh të lehtë, krahasuar me sektorët tjerë, janë

sektori i prodhimit të gomës dhe plastikës, ai i botimeve dhe prodhimeve nga metali, me të dhënat prej 1797 (8.3%), 1716 (8%) dhe 1517 (7%).

Në relacion me numrin më të madh të sektorëve prodhues sikurse që janë: duhani, ai i veshjeve, lëkurës, letrës, rafinimi i naftës, makinave dhe pajisjeve elektrike dhe optike, aparateve elektronike, komunikimit, instrumenteve mjekësore dhe mjeteve të transportit kemi të bëjmë, kryesisht, me biznese të natyrës së vogël apo familjare

**Tabela 12: Të dhënat mbi numrin e te punësuarve karshi nr. të bizneseve dhe qarkullimi vjetor, sipas sektorëve në vlerë dhe përqindje, 2013**

| sektor ët | Industria | Nder. prodhuese | | Të punësuar | | Qarkullimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vlera | % | Vlera | % | Vlera | % |
| DA-15 | Ushqim. Dhe pije | 1288 | 25.2 | 6261 | 29.0 | 338,032,687 | 37.5 |
| DA-16 | Duhanit | 7 | 0.1 | 157 | 0.7 | 19,756,773 | 2.2 |
| DB-17 | Tekstilit | 152 | 3.0 | 951 | 4.4 | 19,592,965 | 2.2 |
| DB-18 | Veshjeve dhe gëzof | 239 | 4.7 | 364 | 1.7 | 4,278,831 | 0.5 |
| DC-19 | Lëkurës dhe prodh. Të lëkurës | 38 | 0.7 | 234 | 1.1 | 6,346,978 | 0.7 |
| DD-20 | Drurit | 596 | 11.7 | 1314 | 6.1 | 30,263,672 | 3.4 |
| DE-21 | Letrës | 93 | 1.8 | 259 | 1.2 | 12,238,540 | 1.4 |
| DE-22 | Botimeve | 323 | 6.3 | 1716 | 8.0 | 55,539,907 | 6.2 |
| DF-23 | Rafinimi i naftës, koksifikimi | 8 | 0.2 | 39 | 0.2 | 9,369,241 | 1.0 |
| DG-24 | Kimike | 135 | 2.6 | 598 | 2.8 | 27,991,297 | 3.1 |
| DH-25 | Gomë&plastikë | 384 | 7.5 | 1797 | 8.3 | 91,030,000 | 10.1 |
| DI-26 | Minerale jo metalike | 473 | 9.3 | 3776 | 17.5 | 171,019,852 | 19.0 |
| DJ-27 | Metaleve | 133 | 2.6 | 747 | 3.5 | 20,417,638 | 2.3 |
| DJ-28 | Prodhimeve prej metali | 623 | 12.2 | 1518 | 7.0 | 47,673,204 | 5.3 |
| DK-29 | Makainave dhe pajisjeve P.C | 34 | 0.7 | 222 | 1.0 | 5,196,858 | 0.6 |
| DL-30 | Paisj. Elektrike dhe optike | 7 | 0.1 | 19 | 0.1 | 556,005 | 0.1 |
| DL-31 | Maikinave dhe aparateve elektr. | 37 | 0.7 | 99 | 0.5 | 4,190,610 | 0.5 |
| DL-32 | Paisj. Aparateve të komunikimit | 6 | 0.1 | 9 | 0.0 | 1,467,294 | 0.2 |
| DL-33 | Instrumenteve mjekësore të preciziteti | 20 | 0.4 | 55 | 0.3 | 2,772,372 | 0.3 |
| DM-34 | Mjeteve të transportit | 5 | 0.1 | 33 | 0.2 | 1,769,354 | 0.2 |
| DM-35 | mjeteve tjera të transporti | 8 | 0.2 | 32 | 0.1 | 1200833 | 0.1 |
| DN-36 | Tjera përpunuese P.C | 374 | 7.3 | 987 | 4.6 | 17,121,477 | 1.9 |
| DN-37 | Rikoperimi | 130 | 2.5 | 386 | 1.8 | 13,770,440 | 1.5 |
| | **Gjithsej: D** | **5113** | **100** | **21573** | **100** | **901,596,828** | **100** |

**Figura 12: Paraqitja grafike e të dhënave mbi numrin e bizneseve, të punësuar dhe qarkullimi vjetor sipas nënsektorëve në përqindje 2013**




## Paga mesatare, sipas aktiviteteve ekonomike

NëTabelën nr. 13, janë paraqitur pagat mesatare të përllogaritura nga pagat mujore për vitin 2010, 2011, 2012, dhe 2013, për aktivitetet ekonomike përkatëse. Nga tabela mund të vëmë re se për vitin 2013, paga mesatare më e lartë ështëpër aktivitetin ekonomik "Organizatat dhe trupat ndërkombëtare" , ndërsa paga mesatare më e vogël ështëpër aktivitetin ekonomik "Prodhimi, përpunimi dhe konservimi i mishit të shpendëve".

**Tabela 13: Pagat mesatare për aktivitetet ekonomike përkatëse**

| Paga mesatare sipas kategorive për vite | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Emertimi simbas kategorive | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
| Tjeter | 357 | 401 | 351 | 474 |
| Arsimi parashkollor dhe fillor | 184 | 288 | 342 | 310 |
| Bankat qendrore | 696 | 532 | 513 | 642 |
| Botimi i librave | 296 | 331 | 286 | 224 |
| Endja e stofrave të leshta - cikli i krehjes | 220 | 223 | 372 | 304 |
| Endja e stovrafe të leshta - cikli i tjerrjes | 677 | 380 | 338 | 430 |
| Endja e tekstileve të pambukëta | 314 | 257 | 210 | 217 |
| Fonderia e çelikut | 225 | 169 | - | - |
| Fonderia e gizës | 510 | 478 | 493 | 442 |
| Gjyetia, ngritja e leqeve, ripopullimi dhe kujdesi ndaj kafsheve të gjahut duke përfshire edhe sherbimet | 305 | 352 | 267 | 227 |
| Kërkime dhe aplikime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humanitare | 605 | 636 | 601 | 566 |
| Këshillime dhe sigurimi i pajisjeve programore (softwar-it | 2,593 | 1,445 | 906 | 857 |
| Kultura e drithërave dhe kulturat industriale (pc)1/ | 466 | 586 | 372 | 337 |
| Kulturat e frutave, të frutave me lëvozhge, të bimëve për pije dhe për erëza | 298 | 281 | 295 | 348 |
| Kulturat e perimeve, hortikultura dhe fidanishtja mbledhjes së këpurdhave pyjore | 450 | 450 | 255 | 170 |
| Lidhja dhe punët përfundimtare | 601 | 606 | 487 | 413 |
| Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve | 360 | 370 | 150 | 150 |
| Ndërmjetësime të tjera monetare | 764 | 697 | 761 | 747 |
| Ndërtimi dhe riparimi i anijeve | - | - | - | - |
| Ndërtimi dhe riparimi i anijeve për argëtim dhe anijeve sportive | - | - | - | - |
| Ngarkimi - shkarkimi i peshave | 657 | 674 | 732 | 632 |
| Nxjerrja dhe aglomerimi i linjiteve dhe thëngjillit te murrëm | 750 | 687 | 196 | 115 |
| Nxjerrja e gurit gëlqeror, të gipsit dhe të gëlqeres natyrore | 207 | 256 | 228 | 184 |
| Nxjerrja e gurit për ndërtime | 205 | 251 | 216 | 215 |
| Nxjerrja e mineralit të hekurit | 301 | 305 | 303 | 289 |
| Nxjerrja e mineralit të metaleve jo ferro-manjetike(al, cu, kr etj) përveq uraniumit dhe toriumit | 450 | 446 | 160 | 149 |
| Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit | 836 | 705 | 515 | 391 |
| Nxjerrja e shistit argjilor | 270 | 301 | 252 | 207 |
| Organizatat dhe trupat ndërkombëtare | 1,268 | 1,491 | 1,320 | 1,271 |
| Përgatitja dhe endja e stofrave të leshta - cikli i tjerrjes | 150 | 813 | 327 | 194 |
| Përgatitja dhe filaturimi i fibrave të pambukut | - | - | - | - |
| Përgatitja dhe tanini i lekurës | - | - | - | - |
| Përpunimi dhe konservimi i peshkut dhe i produkteve të peshkut | 388 | 331 | 291 | 274 |
| Petëzimi në të ftohtë | 718 | 610 | 202 | 14 |
| Prodhimi dhe riparimi i aeroplanëve dhe fluturakeve kozmike | 422 | 673 | 634 | 725 |
| Prodhimi i artikujve të udhëtimit, të galanterise dhe të pajimeve të kuajve | 416 | 450 | 557 | 498 |
| Prodhimi i cimentos | - | 567 | 633 | 578 |
| Prodhimi i derivateve të naftës | 503 | 398 | 184 | 207 |
| Prodhimi i furnirit, rimesos, i panelave te veçanta dhe fibrave | 463 | 475 | 238 | 185 |
| Prodhimi i gomave të brendshme e të jashtme të automjeteve | 450 | 389 | 408 | 364 |
| Prodhimi i instrumenteve dhe aparateve për matje, kontroll, hulumtim, për destinime të lundrimit dhe destinime të tjera, perveç pajisjeve të kontrollit për procese industriale | - | - | 321 | 414 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi i kazaneve me avull, përvec kazanave për nxemje qëndrore me ujë të ngrohët | 448 | 489 | 193 | 156 |
| Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre | 300 | 509 | 434 | 250 |
| Prodhimi i makinave të tjera bujqësore pyjore | 660 | 325 | 284 | 270 |
| Prodhimi i marrësve televiziv, radiomarrësve, aparateve për inçizimin dhe riprodhimin e zërit dhe të fotografisë dhe të pajisjes përcjellëse | - | 150 | - | 100 |
| Prodhimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera organike | - | - | - | 170 |
| Prodhimi i pllakave, fletëve, tubave e profileve prej plastike | 338 | 339 | 325 | 345 |
| Prodhimi i preparateve farmaceutike | 990 | 577 | 436 | 362 |
| Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë me përdorim mjekësor | 242 | 248 | 216 | 202 |
| Prodhimi i produkteve prej tepe, kashte dhe artikuj të tjerë të shporterise | 569 | 431 | 273 | 193 |
| Prodhimi i produkteve të tjera prej druri | 672 | 457 | 269 | 218 |
| Prodhimi i profileve për goma të jashtme | 244 | 267 | 213 | 224 |
| Prodhimi i qelqit te shështë | 300 | 280 | 19 | - |
| Prodhimi i radiatorëve dhe prodhimi i kazanave me avull,për ngrohje qendrore | - | 1,094 | 380 | 487 |
| Prodhimi i sapuneve, detërxhentëve dhe i produkteve tëpastrimit e shkëlqimit | 1,149 | 1,636 | 509 | 441 |
| Prodhimi i traktorëve për bujqësi | 730 | 730 | 107 | 90 |
| Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve për ndërtim me baltë të pjekur | 2,047 | 2,203 | 1,070 | 904 |
| Prodhimi i zdrukthtarisë dhe elementeve të ndërtimtarisë(trare, dritare, dyer etj) | 408 | 404 | 421 | 401 |
| Prodhimi, përpunimi dhe konservimi i mishit | - | - | 100 | 150 |
| Prodhimi, përpunimi dhe konservimi i mishit të shpendëve | - | 255 | 53 | 132 |
| Restaurante | 450 | 450 | 192 | 166 |
| Rritja e kafshëve të tjera | 384 | 383 | 282 | 295 |
| Shembja e ndërtesave dhe përgatitja e tokave | 598 | 663 | 572 | 549 |
| Shërbime plotësuese në kultura bujqësore | 439 | 370 | 350 | 432 |
| Shërbimet e postave publike (shtetërore) | 794 | 775 | 825 | 905 |
| Shtypja e gazetave | 343 | 326 | 298 | 259 |
| Shtypje te tjera | 374 | 357 | 276 | 261 |
| Telekomunikimet | 318 | 341 | 354 | 340 |
| Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni | 628 | 628 | 261 | 194 |
| Transporti detar dhe bregdetar | 817 | 754 | 687 | 691 |
| Tregëtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave | 526 | 528 | 231 | 92 |
| Tregtia me pakicë e bukës, simiteve, ëmbëlsirave, brumërave, sheqerkave dhe pastave | 188 | 222 | 205 | 257 |
| Tregtia e automjeteve motorike | - | - | - | - |
| Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit | 1,208 | - | - | - |
| Tregtia me pakicë e pemëve dhe perimeve | 573 | 525 | 563 | 538 |
| Tregtia me pakicë e peshkut, guasave dhe gaforreve | 1,207 | 1,267 | 1,565 | 1,332 |
| Tregtia me shumicë e luleve dhe e bimëve | 809 | 950 | 903 | 869 |
| Vendosja e izolatorëve | 592 | 581 | 509 | 447 |
| Veprimtari të mbrojtjes sociale me strehim | 520 | 545 | 439 | 392 |
| Veprimtari të mbrojtjes sociale pa strehim | 1,612 | 1,244 | 792 | 1,191 |
| Veprimtari të veterinerisë | 499 | 553 | 524 | 431 |
| Veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë dhe këshillime në lidhur me to | 212 | 205 | 275 | 479 |

## Numri i bizneseve të angazhuara sipas rajoneve nëpër nënsektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës, për vitin 2013

Sa i përket numrit të bizneseve nëpër rajone, të dhënat e paraqitura nëTabelën nr. 14, tregojnë se Prishtina është rajoni,i cili merr peshën kryesore, kur kemi të bëjmë me përqendrimin e ndërmarrjeve,1413 biznese apo 28 % nga totali i përgjithshëm i tyre përgjatë vitit 2013. Pas rajonit të Prishtinës radhitet Gjilani,me 1289 biznese apo 25 % nga numri i përgjithshëm i pasuar nga Prizreni, me 1125 ndërmarrje apo 22 % të totalit të bizneseve. Në vitin 2012, në rajonin e Pejës numri i bizneseve ishte 652, apo 14.1% nga totali i përgjithshëm i bizneseve, ndërsa në vitin 2013, kjo shifër shënoi ngritje, në 18.1% apo 923 biznese.

Përderisa nërajonin e Gjilanit, në vitin 2013, kemi shtim të numrit të bizneseve krahasuar me vitin 2012, nga 1213 në 1289, në rajonin e Mitrovicës, sipas tëdhëave të paraqitura, vërehet njëramje e lehtë nga 370, sa ishin në vitin 2012, në 363 sosh.

**Tabela 15:Numri i bizenesevesipas rajoneve në nivel të Kosovës, 2012/2013**

| Komuna | 2012 Nr.i Ndërmarrjeve | 2012 % | 2013 Nr.i Ndërmarrjeve | 2013 % | 2013/2012 % |
|---|---|---|---|---|---|
| Mitrovicë | 370 | 8.0 | 363 | 7.1 | -1.9 |
| Pejë | 652 | 14.1 | 923 | 18.1 | 41.6 |
| Prizren | 1044 | 22.5 | 1047 | 20.5 | 0.3 |
| Gjilani | 1213 | 26.2 | 1367 | 26.7 | 12.7 |
| Prishtinë | 1352 | 29.1 | 1413 | 27.6 | 4.5 |
| **Gjithsej** | **4.631** | 100.0 | **5.113** | 100.0 | 10.4 |

**Figura 14: Paraqitja grafike e numrit të bizenesevesipas rajoneve në nivel të Kosovës, 2012/ 2013**



**<u>Numri i  bizneseve, sipas komunave, në rajonin e Prishtinës, nëpër nënsektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës,për vitin 2013</u>**

Prishtina, sipas tëdhëave nëTabelën nr. 16, është rajoni, i cili paraprin me numrin e bizneseve në vitin 2013, me 1413 biznese apo rreth 60 % nga numri i përgjithshëm i bizneseve. prej të cilave 915 të regjistruara nëKomunën e Prishtinës. Veprimtaria ushqimore është ajo e cila aktualisht i paraprin prodhimit, në këtë rajon me gjithsej220 biznese pastaj ajo botuese me 182 sosh të pasuara nga prodhimi i produkteve prej metali, përveç makinave dhe pajisjeve me 89 biznese të regjistruara.

Në pesë komunat tjera të këtij rajoni, siç janë: Podujeva, Fushë-Kosova, Lipjani, Drenasi (Gllogoci) dhe Kastrioti (Obiliqi)janë të regjistruara rreth 30% e bizneseve, nga numri i përgjithshëm  i tyre në rajon.Komuna e Podujevës, edhe pse me një numër të vogël të bizneseve të regjistruara, 145 sosh apo 10% nga totali i bizneseve, radhitet e dyta në rajon dhe kryesisht përfaqësohet nga sektori i prodhimeve ushqimore dhe ai i prodhimit të produkteve prej metali përveç makinave dhe paisjeve. Komuna e Lipjanit, në vitin  2013, radhitet e treta për nga numri i regjistrimit të bizneseve, me 113, në këtë rajon dhe vetëm me  shtatë biznese më pak, apo 106 sosh, është Fushë-Kosova.

**Tabela 16: Numri i  bizneseve sipas Komunave në regjionin e Prishtinës, nëpër nënsektoret e prodhimit industrial në nivel Kosove për vitin 2013**

| Komuna-ID | Produktet e ushqimit 15 | Produktet e duhanit 16 | Produktet e tekstilit 17 | Prod. e veshjeve dhe gëzofit 18 | Prodh. e lëkurës dhe produkteve nga lëkura 19 | Prodh. e drurit dhe produkteve nga druri 20 | Pordh. I brumit të letrës dhe porodukteve të letrës 21 | Veprimtaria botuse 22 | Prodhimi i derivateve të naftës 23 | Prodhimi i kemikaleve dhe prodhimeve kimike 24 | Prodh. I prod. Nga goma dhe plastika 25 | Prodh. I prod. Tjera minerale jo metalike 26 | Prodh. I metaleve dhe prod. Prej metali 27 | Pro. I prod. Prej metali ïërveq makinave dhe paisjeve 28 | Prodh, i makinave dhe paisjeve 29 | Pro. I paisjeve elektrike dhe optike 30 | Pro. I makinave dhe aparateve elektrike 31 | Pro. I paisjeve dhe aparateve të rtv. 32 | Pro. I instrumenteve mjekësore dhe optike 33 | Prodh, i mjeteve të transportit 34 | Pro. I mjeteve tjera transportuese 35 | Prodh, i mobileve dhe industrit tjera 36 | Rikoperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike 37 | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 03 Gllogoc | 12 | | 2 | 1 | | 13 | 2 | 2 | | 4 | 14 | 19 | 1 | 10 | 1 | | | | | | | 5 | 5 | **91** |
| 09 F.Kosovë | 25 | | | 5 | | 7 | 3 | 7 | | 7 | 13 | 6 | 5 | 14 | | | | | 1 | | 2 | 6 | 5 | **106** |
| 13 Lipjan | 27 | | 2 | 1 | | 14 | 1 | | 1 | 6 | 14 | 19 | 5 | 10 | | | 1 | | | | | 2 | 10 | **113** |
| 15 Obiliq | 12 | | | 1 | | 3 | 1 | 1 | | | 5 | 6 | 1 | 7 | 1 | | | | | | | 1 | 4 | **43** |
| 18 Podujevë | 37 | | 1 | 9 | 1 | 21 | 1 | 6 | | 3 | 15 | 8 | 3 | 26 | | | 1 | | | | | 10 | 3 | **145** |
| 19 Prishtinë | 220 | 2 | 28 | 43 | 3 | 58 | 27 | 182 | 2 | 30 | 36 | 37 | 25 | 89 | 9 | 4 | 16 | 2 | 8 | 2 | 3 | 64 | 25 | **915** |
| **Gjithsej** | **333** | **2** | **33** | **60** | **4** | **116** | **35** | **198** | **3** | **50** | **97** | **95** | **40** | **156** | **11** | **4** | **18** | **2** | **9** | **2** | **5** | **88** | **52** | **1413** |

**Figura 15: Paraqitja grafike e numrit të bizneseve sipas komunave në rajonin e Prishtinës, nëpër nësektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës, për vitin 2013**




## <u>Numri i bizneseve sipas komunave – rajoni i Mitrovicës nëpër nësektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës, për vitin 2013</u>

Të dhënat nëTabelën me nr. 17 tregojnë se gjatë vitit 2013, në rajonin e Mitrovicës janë regjistruar 363 biznese, duke marrë për bazë se kemi të dhëna të pakta për numrin e bizneseve në komunat:Zveçan, Leposaviq dhe Z. Potok. Nënsektori i cili paraprin në këtë rajon është ai i prodhimit të produkteve ushqimore,gjithsej 52 biznese, i pasuar nga ai i prodhimeve tëdrurit dhe produkteve nga druri me 26 biznese të regjistruara.

Në këtë rajon, Mitrovica i paraprin procesit në relacion me numrin e bizneseve të regjistruara me gjithsej 166 sosh, pastajështë Vushtrria me 130 dheSkënderaj, me 54 biznese, të dhëna nga Leposaviqi dhe Zveçani, 10 respektivisht 3biznese të regjistruara në vitin 2013.

**Tabela17: Numri i bizneseve sipas komunave në rajonin e Mitrovicës, nëpër nësektorët e prodhimit industrial në nivel të Kosovës, për vitin 2013**

| Komuna-ID | 15 Produktet e ushqimit | 16 Produktet e duhanit | 17 Produktet e tekstilit | 18 Prod. e veshjeve dhe gëzofit | 19 Prodh. e lëkurës dhe produkteve nga lëkura | 20 Prodh. e drurit dhe produkteve nga druri | 21 Pordh. I brumit të letrës dhe porodukteve të letrës | 22 Veprimtaria botuse | 23 Prodhimi i derivateve të naftës | 24 Prodhimi i kemikaleve dh prodhimeve kimike | 25 Prodh. I prod. Nga goma dhe plastika | 26 Prodh. I prod. Tjera minerale jo metalike | 27 Prodh. I metaleve dhe prod. Prej metali | 28 Pro. I prod. Prej metali jërveq makinave dhe | 29 Prodh, i makinave dhe paisjeve | 30 Pro. I paisjeve elektrike dhe optike | 31 Pro. I makinave dhe aparateve elektrike | 32 Pro. I paisjeve dhe aparateve të rtv. | 33 Pro. I instrumenteve mjekësore dhe optike | 34 Prodh, i mjeteve të transportit | 35 Pro. I mjeteve tjera transportuese | 36 Prodh, i mobileve dhe industrit tjera | 37 Rikoperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalik | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 Mitrovicë | 52 | | 6 | 5 | 4 | 26 | 2 | 8 | | 2 | 7 | 15 | 4 | 13 | | | 2 | | | | 1 | 10 | 9 | **166** |
| 12 Leposaviq | 2 | | 1 | | | 1 | | | | 1 | | 3 | | 2 | | | | | | | | | | **10** |
| 21 Skenderaj | 14 | | 1 | 2 | 1 | 6 | | 2 | | | 9 | 10 | 1 | 5 | | | | | | | | 2 | 1 | **54** |
| 27 Vushtrri | 41 | | 2 | 11 | | 13 | 2 | 2 | | 4 | 4 | 5 | 5 | 25 | | | | | 1 | | | 11 | 4 | **130** |
| Z. Potok | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | **0** |
| 29 Zveqan | 1 | | | | | | | | | | | 1 | | 1 | | | | | | | | | | **3** |
